



Alexander Kohler është një ekspert i politikave të arsimit të lartë dhe sigurimit të cilësisë. Ai aktualisht po punon me Ministrinë Federale Austriake të Arsimit, Shkencës dhe Kërkimit me fokus specifik në financimin e universiteteve publike përmes marrëveshjeve të performancës, mbi cilësinë e mësimdhënies dhe mbi zbatimin e reformës së arsimit të mësuesve në Austri.

Ai punon gjithashtu edhe si konsulent i pavarur në projekte ndërkombëtare të ndrsyhme që kanë lidhje me politikat e arsimit të lartë, menaxhimin e cilësisë institucionale dhe akreditimin (si psh. Evropa Jug-Lindore dhe Afrika).

Në vitin 2004 ai krijoi dhe menaxhoi Agjencinë Austriake për Sigurimin e Cilësisë, institucion që këshilloi dhe auditoi një sërë Institucionesh të Arsimit të Lartë austriake dhe vendeve të tjera Evropiane. Në këtë pozicion ai ka qenë anëtarë i disa grupesh të ndrsyhme ekspertësh ndërkombëtare apo rrjetesh ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë.

Nga viti 1999-2004, ai drejtoi Agjencinë Kombëtare Austriake në programin "Leonardo da Vinci". Përvoja ndërkombëtare e Aleksandrit përfshin gjithashtu punësimin e tij si një ekspert i dytë kombëtarë në Komisionin Evropian në Bruksel dhe Qendrën Evropiane për Zhvillimi i Trajnimit Profesional (Cedefop) në Selanik (1996 deri 1999). Fushat kryesore të hulumtimit dhe punës së tij përfshijnë financimin e arsimit dhe zhvillimin e burimeve njerëzore.